

Zyra e Komisionerit nis hartimin e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit nr. 12/2026 “Për Lobimin në Republikën e Shqipërisë”

Pas miratimit të ligjit nr. 12/2026 “Për Lobimin në Republikën e Shqipërisë”, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka nisur punën për hartimin e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin efektiv të tij.



Procesi po zhvillohet në bashkëpunim me ekspertët e Këshillit të Evropës (KiE) dhe përfaqësuesit e Zyrës së Komisionerit, të cilët po punojnë për përgatitjen e kuadrit rregullator që do të mundësojë funksionimin e regjistrimit të lobimit, procedurat administrative, formatet standarde dhe mekanizmat e transparencës e kontrollit të parashikuara në ligj.

Aktualisht janë në proces hartimi disa akte nënligjore, të cilat lidhen me:

- formatet dhe periudhat e raportimit të aktiviteteve të lobimit;
- strukturimin dhe administrimin e Regjistrimit të Lobimit;
- procedurat e regjistrimit dhe shqyrtimit të kërkesave;
- kategoritë e dokumentacionit që duhet të ruhen nga lobistët;
- formatin dhe mënyrën e dorëzimit të deklaratave të lobimit;
- procedurat për identifikimin dhe menaxhimin e konflikteve të interesit;
- procedurat dhe afatet për verifikimin e saktësisë së të dhënave të regjistruara.

Këto dokumente janë ende në fazën e draftimit dhe po përpunohen në përputhje me standardet më të mira evropiane në fushën e transparencës dhe integritetit të veprimtarisë së lobimit.

Pas përfundimit të hartimit paraprak, projektaktet do të publikohen për konsultim publik, me qëllim përfshirjen e institucioneve, organizatave të interesit, ekspertëve dhe publikut në procesin e finalizimit të tyre.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë muajit qershor 2026 ka dhënë dy vendime në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”). Sipas [vendimit nr. 21, datë 15.06.2026](#), Komisioneri ka pranuar ankesën ndaj Operatorit të Blerjeve të Përqendruara sh.a. (në vijim “OBP”) dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (në vijim “QSUT”), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës së datës 09.03.2026, depozituar pranë OBP, kishte kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit për blerjen e pajisjeve mjekësore CT Skanner për Shërbimin e Urgjencave Polivalente. Ankuesi kishte kërkuar kopje të trajtimit të ankesës nga autoriteti kontraktor OBP, praktikën shkresore ndërmjet dy autoriteteve publike OBP dhe QSUT, si dhe urdhrin për ngritjen e grupit të punës që kishte hartuar specifikimet teknike.

Pas administrimit të ankesës, Komisioneri konstatoi se ajo përmbushte kriteret formale të ligjit dhe u kërkoi autoriteteve publike të paraqisnin shpjegimet e tyre.

OBP sqaroi se dokumentacioni i kërkuar nuk ishte hartuar apo administruar prej tij, por i përkiste QSUT, e cila kishte kompetencën për hartimin e specifikimeve teknike, ngritjen e grupit të punës dhe administrimin e dokumentacionit teknik përkatës.

Nga ana tjetër, QSUT argumentoi se roli i saj kishte qenë vetëm teknik dhe se identiteti i anëtarëve të grupit të punës nuk duhej të bëhej publik për të shmangur ndikime apo presione ndaj tyre.

Për garantimin e një shqyrtimi të plotë dhe objektiv, Komisioneri zhvilloi edhe një seancë dëgjimore me pjesëmarrjen e palëve. Gjatë shqyrtimit rezultoi se kopja e vendimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik i ishte vënë ndërkohë në dispozicion ankuesit, ndërsa praktika shkresore ndërmjet autoriteteve publike dhe urdhri për ngritjen e grupit të punës ekzistonin, por nuk ishin bërë të aksesueshme.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të autoriteteve publike dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerësoi se si OBP ashtu edhe QSUT janë autoritete publike në kuptim të nenit 2 të LDI dhe, për rrjedhojë, kanë detyrimin ligjor për të garantuar aksesin në informacionin publik që prodhojnë ose

Vendim Nr. 21 - Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Vendim Nr. 22 - Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

administrojnë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Komisioneri arriti në përfundimin se praktika shkresore ndërmjet dy autoriteteve publike përbënte informacion publik, në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të LDI. Për rrjedhojë, fakti që dokumentacioni ishte hartuar ose administrohej nga QSUT e ngarkonte këtë autoritet me detyrimin për ta vënë atë në dispozicion të kërkuarit, duke respektuar vetëm kufizimet e parashikuara në pikën 6 të nenit 17 të LDI, nëse ndonjë pjesë e dokumentacionit duhej të kufizohej.

Gjithashtu, u theksua se emrat e nëpunësve publikë që marrin pjesë në grupe pune apo organe kolegjiale lidhen me ushtrimin e funksioneve të tyre zyrtare dhe jo me jetën private, ndaj nuk mund të kufizohen mbi bazën e pretendimeve të përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave personale.

Komisioneri arriti në përfundimin se autoriteti publik nuk kishte argumentuar ekzistencën e një dëmi konkret që do të justifikonte kufizimin e së drejtës për informim, nuk kishte kryer testin e proporcionalitetit dhe as testin e dëmit, ndërsa pretendimet për rrezikun e ushtrimit të presioneve ndaj specialistëve mbeteshin hipotetike dhe të pambështetura në prova.

Për këto arsye, Komisioneri pranoi ankesën ndaj autoriteteve publike QSUT dhe OBP dhe urdhëroi QSUT të vinte në dispozicion të ankuesit praktikën shkresore ndërmjet saj dhe OBP, si dhe kopjen e urdhrit për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, në përputhje me parashikimet e LDI.

Zyra e Komisionerit promovon transparencën dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile për integrimin në BE

Më 19 qershor 2026 u zhvillua Konferenca e Konventës Kombëtare për Integrimin Evropian, me temë “Përtej Tryezës së Negociatave: Një Angazhim Kuptimplotë i Shoqërisë Civile për Anëtarësimin në Bashkimin Evropian”, një forum i rëndësishëm dialogu mbi rolin e institucioneve dhe shoqërisë civile në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u përfaqësua në Panelin Tematik “Ndërtimi i Besimit përmes Drejtësisë, Llogaridhënies dhe Transparencës” nga znj. Ermelinda Pema, Drejtore e Monitorimit të Programit të Transparencës.

Gjatë panelit, ku u diskutua mbi pavarësinë dhe llogaridhënien e sistemit të drejtësisë, transparencën, të drejtën e informimit dhe besimin e publikut tek institucionet, përfaqësuesja e Zyrës së Komisionerit prezantoi përvojën e institucionit në bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe kontributin e tij në forcimin e transparencës dhe pjesëmarrjes publike.



Në këtë kuadër, u prezantuan tri tryeza të bashkorganizuara me EMA, të zhvilluara në kuadër të një projekti që synon institucionalizimin e debatit publik dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe aktorëve joshtetërorë:

- “Zbatimi i Ligjit të Ri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kontekstin e Negociatave për Kapitullin 23: Dialog me Shoqërinë Civile dhe Sektorin Privat” (15 korrik 2025);
- “Adresimi i Sfidave në Zbatimin e së Drejtës për Informim: Mangësitë në Kapacitetet Institucionale, Refuzimet e Pajustificuara dhe Pengesat Kryesore” (13 nëntor 2025);
- “Rregullimi i Lobimit në Shqipëri: Forcimi i Transparencës, Sfidat në Zbatim dhe Koordinim, si dhe Standardet Evropiane” (22 maj 2026).

Pjesëmarrja në këtë konferencë shërbeu si një mundësi për të ndarë përvojën institucionale, për të diskutuar sfidat aktuale në fushën e transparencës dhe së drejtës së informimit, si dhe për të forcuar bashkëpunimin me aktorët e shoqërisë civile në funksion të avancimit të procesit të integritimit evropian të Shqipërisë.

Zyra e Komisionerit prezanton përvojën shqiptare në seminarin evropian për të drejtën e informimit dhe të dhënat e hapura

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë në seminarin ndërkombëtar “Case Handling Workshop – FOI 2026”, i zhvilluar në Tallinn, Estoni, me pjesëmarrjen e rreth 30 përfaqësuesve nga autoritetet përgjegjëse për transparencën, të drejtën për informim dhe të dhënat e hapura nga vende të ndryshme evropiane.



Zyra e Komisionerit u përfaqësua nga znj. Emerlinda Pema, Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit të Programeve të Transparencës, znj. Alketa Sata, Inspektor në Drejtorinë e të Dhënave të Hapura dhe Konsultimit Publik, si dhe znj. Bora Tafa, Inspektor në Drejtorinë e Monitorimit të Programeve të Transparencës.



Seminari u organizua nga Inspektorati i Mbrojtjes së të Dhënave të Estonisë dhe u fokusua në shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira për gjetjen e balancës ndërmjet së drejtës për informim dhe së drejtës së aksesit sipas nenit 15 të GDPR, si dhe në zbatimin e legjislacionit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit publik.

Gjatë ditës së parë, kushtuar ripërdorimit të informacionit të sektorit publik, përfaqësueset e Zyrës së Komisionerit zhvilluan prezantimin e parë të seminarit, duke paraqitur kuadrin ligjor shqiptar për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit publik, si dhe masat e ndërmarra për ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e ndërgjegjësimit për zbatimin e këtij ligji. Prezantime mbi këtë tematikë u zhvilluan gjithashtu nga autoritetet e Azerbajxhanit, Kroacisë, Hungarisë dhe Estonisë.

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale:

